34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

## **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39           Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40           Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41           Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42           Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43           Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-24-1175-5-2-1/C923

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është <b>10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj</b> .  Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitim të sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <b>5 ditë</b> kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <b>5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit</b> .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <b>sipas urdhëresës me shkrim të menaxherit të kontratës</b> .
	17.2	Përfundimi i të gjitha punëve do të jetë brenda 24 muajve, sipas urdhëresës së menaxherit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë</b> .  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10% e</b>

		Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	<b>Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,</b>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <b>nuk ka pagese paraprake</b>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>nuk është e nevojshme</b>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <b>15</b> ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është <b>24 muaj</b>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <b>përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.</b>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<b>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</b>



# PARAMASA DHE PARALLOGARIA

ÇERDHE TIPIKE | P+1

LOKACIONI: ROGOVË GJAKOVË

INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË

VËREJTJE:

Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristikat e njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me çertifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv. Në të gjitha pozicionet përfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E GERMIMET TË PËRFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NE DEPONI.

## 1 PUNËT NDËRTIMORE

### 1.01 PUNËT PARAPREGADITORE DHE DEMOLUESE

POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me TVSH	SHUMA totale me TVSH
1.01.01	Rrethimi dhe sigurimi i punishtes me konstrukcion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të punishtes dhe shënjëzimi informativ me tabelën Informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilet e hekurit dhe llarina. Dimensionet e parcelës imagjinare: 100x90 m.	komplet	1	250.00 €	250.00 €
1.01.02	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndërtimi të kantierit, veçndosja e kontejnerit për zyrën e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1	250.00 €	250.00 €
1.01.03	Pozicionimi gjeodezik dhe shënjëzimi i objektit për ndërtim	komplet	1	250.00 €	250.00 €
1.01.04	Pastrimi i tërësishëm i objektit dhe terrenit rreth objektit pas përfundimit të punimeve nga të gjitha ndërtimet e përkohshme, rrethojat, mbeturinat inerte dhe ambalazhet e paketimit e materialeve, etj.	komplet	1	250.00 €	250.00 €
1.01.05	Te behet demolimi i rezervoarit nentokesor tek hapësra ku parashihet ndërtimi i objektit, transporti, deponimi (deponimi) i mbeturinave deri në deponinë e përcaktuar nga komuna. Gjithashtu te parashihet edhe mbushja dhe ngjeshja e hapësres me zhavor pasi te behet largimi i rezervoarit. Rezervoari te deponohet në vendin që e cakton Menaxheri i kontrates.	komplet	1	2,000.00 €	2,000.00 €
<b>TOTAL POZICIONI me TVSH</b>				<b>1.01</b>	<b>3,000.00 €</b>

### 1.02 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT

POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me TVSH	SHUMA totale me TVSH
1.02.01	Gërmimi i shtresës së humusit dhe dheut me trashësi 50 cm (kuota - 0.85) në tërë sipërfaqen e paraparë për pozicionimin e objektit. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. <b>Vërejtje:</b> Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkëmbësorisë. <b>Vërejtje:</b> Një sasi e dheut duhet të mbetet në punishte për mbushjet eventuale dhe modelimin e oborrit.	m <sup>3</sup>	245.00	3.00 €	735.00 €
1.02.02	Gërmimi i dheut me makineri dhe dorë deri në 180 cm thellësi për hapjen e kanaleve për themelet shiritore të objektit. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. <b>Vërejtje:</b> Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkëmbësorisë.	m <sup>3</sup>	1,404.00	2.00 €	2,808.00 €
1.02.03	Gërmimi i dheut me makineri dhe dorë deri në 180 cm thellësi për hapjen e kanaleve për themele te mureve mbrojtëse. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. <b>Vërejtje:</b> Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkëmbësorisë.	m <sup>3</sup>	90.00	3.00 €	270.00 €
1.02.04	Gërmimi i shtresës së humusit dhe dheut me trashësi deri 40 cm në tërë sipërfaqen e paraparë për platonë dhe shigjet e këmbësorëve dhe pjesës së parkingut me rrugën e re. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. <b>Vërejtje:</b> Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkëmbësorisë.	m <sup>3</sup>	244.00	3.00 €	732.00 €
1.02.05	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 10 cm me fraksion 0/31 në tërë gjerësinë e kanaleve të hapura rreth mureve perimetrike të themeleve dhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë Ms=30 MPa. <b>Vërejtje:</b> Për shkak të pasaktësive gjatë punës dhe mundësisë së humbjes së materialit në shtresën e dheut sasija e llogaritur është rritur për 50%	m <sup>3</sup>	50.00	10.00 €	500.00 €



*Handwritten signature: S. J. Zencu*

*Handwritten signature: VALINA KAMISHI ZEKA*

1.02.06	Furnizimi me material dhe mbushja e hapësirës përgjatë mureve perimetrike, hapësirave mes mureve si dhe punimi i tamponit nga zhavori nën pllakën e themelit me trashësi 40 cm me fraksion 0/31 duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijen e kompaktësisë MS=30 MPa. <b>Vërejtje:</b> Mbushja të realizohet pas betonimit të mureve të themeleve perimetrike deri në kuotën -0.35 për tërë gabaritin e objektit dhe pas veshjes së anës së brendshme me termoizollim XPS si në detal.	m <sup>3</sup>	1,200.00	3.00 €	3,600.00 €
1.02.07	Furnizimi me material dhe mbushja e hapësirës përgjatë themelit dhe perimetrit të mureve mbrojtëse, me trashësi 20 cm me fraksion 0/31 duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijen e kompaktësisë MS=40 MPa.	m <sup>3</sup>	95.00	10.00 €	950.00 €
<b>TOTAL ROZICIONI me TVSH</b>				1.02	<b>9,595.00 €</b>
<b>1.03 PUNËT E BETONIT</b>					
<b>POS</b>	<b>PËRSHKRIMI I PUNEVE</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI/NJËSI me TVSH</b>	<b>SHUMA totale me TVSH</b>
	<b>VËREJTJE 1:</b> Punëkryesi është i obliguar që të marr mostrat e betonit për çdo 'parti' betoni, të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre, dërgimin në laboratore të specializuara për shqyrtimet e nevojshme dhe sigurimin e raporteve përkatëse për të gjitha mostrat. <b>VËREJTJE 2:</b> Për pozicionet e parapara të betonohen me shlesa të specifikuar si më poshtë punëkryesi obligohet që të veproj sipas udhëzimeve të prodhuesit duke ju përmbajtur reçetës së përzierjes, duke respektuar raportet e përzierjes ujë-cimento-agregat ndërsa aditivet e kërkuara duhet të shtohen në mikser pas ardhjes në punishte në prani të organit mbikqyrës.				
1.03.01	Furnizimi me material dhe punimi i bazës për mbështetjen e elementeve të lidhura të armaturës së themeleve perimetrike. Betonimi të bëhet me beton të varfër të markës c-16/20 me trashësi min. 10 cm mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal.	m <sup>3</sup>	45.00	40.00 €	1,800.00 €
1.03.02	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i shtyllave të themeleve shiritore. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arrijen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	101.00	100.00 €	10,100.00 €
1.03.03	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i mureve perimetrike të themeleve me trashësi 25 cm deri në nivel të pllakes së perdheses. Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37 me aditiv kristalor për arrijen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	45.50	100.00 €	4,550.00 €
1.03.04	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i themelit pllakë (pllakes së perdheses) në kuotën ± 0.00 me trashësi 25 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arrijen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	71.33	100.00 €	7,133.00 €
1.03.05	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i shtyllave të me dimensione 25x100 cm, 25x60 cm, 25x105 cm si dhe mureve nga betoni i armuar me dimensione 25x250 cm. Shtyllat dhe muret të betonohen deri në kuotën + 2.90 (+7.00). Betonimi të bëhet me beton të markës c-30/37. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	38.50	100.00 €	3,850.00 €
1.03.06	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i mureve perimetrike me trashësi t=25cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	20.00	100.00 €	2,000.00 €
1.03.07	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i pllakes së meskallit me trashësi 20 cm, trashësi me lartësi totale h=50 cm, duke përfshirë edhe betonimin e shkallëve të brendshme. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. <b>VËREJTJE:</b> Gjalë betonimit të pllakave duhet të kushtohet kujdes dimensioneve të hapjes së ashensorit dhe përfundimit në nivelin e fundit.	m <sup>3</sup>	79.00	100.00 €	7,900.00 €



1. VALINA RAMISIJI ZEKU

2. Shkruar nga...

3. Shkruar nga...

1.03.08	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i pllakes se kulmit me trashësi 20 cm , trarët me lartësi totale h=50 cm, duke përfshihet edhe betonimin e shkallëve të brendshme. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. <b>VEREJTJE:</b> Gjatë betonimit të pllakave duhet ti kushtohet kujdes dimensioneve të hapjes së ashensorit dhe përfundimit në nivelin e fundit.	m <sup>3</sup>	79.00	100.00 €	7,900.00 €	
1.03.09	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i mureve të holla me trashësi 12 cm dhe lartësi 50 cm për krijimin e atikës së strehëve mbi përchesë dhe alyre me lartësi 60 cm për krijimin e kanaleve për ullaqet e fshehura në nivelin e kulmit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	76.50	100.00 €	7,650.00 €	
1.03.10	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i cerklazheve horizontale (trarët mbi dyer) me dimensione 25x20 cm si dhe i cerklazhit mbi muret e terasës. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	5.50	100.00 €	550.00 €	
1.03.11	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i shkallëve dhe rampave/pjerrinave tek hyrje/daljet në objekt në nivelin e përchesës. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Pozicionet duhet të realizohen si elemente të mbështetura mbi tokën/zhavorin e ngjeshur duke u lidhur me muret perimetrike të themelit me anë të ankerave të lënë më parë. Thellësia e fondimit -0.60. Në çmim të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m <sup>3</sup>	15.50	100.00 €	1,550.00 €	
1.03.12	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i shputave të themeleve dhe murt mbrojtës le parapare sipas projektit për mbrojtjen e dheut tek casjet ne objekt. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. <b>VEREJTJE:</b> Muri të punohet me pahi të reja që të ketë pamje të mire për shkak se nuk ngjyroset.	m <sup>3</sup>	60.00	100.00 €	6,000.00 €	
<b>TOTAL POZICIONI me TVSH</b>				1.03	60,983.00 €	
<b>1.04 PUNËT E ARMIMIT</b>						
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me TVSH	SHUMA totale me TVSH	
	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brnjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet jenë të pastra nga korozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.					
1.04.01		Ø 8	kg	5,458.65	0.80 €	4,366.92 €
1.04.02		Ø10	kg	3,885.56	0.90 €	3,497.00 €
1.04.03		Ø12	kg	32,985.32	0.90 €	29,686.79 €
1.04.04		Ø14	kg	4,015.45	0.90 €	3,613.91 €
1.04.05		Ø16	kg	8,796.42	0.90 €	7,916.78 €
1.04.06		Ø20	kg	498.54	0.80 €	398.83 €
<b>TOTAL POZICIONI me TVSH</b>				1.04	49,480.23 €	

1. VARMA KAMISHI ZERA
2. Shkurti Syle Syle
3. Isa Zariq - Haxhi



1.05 PUNËT E MURATIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me TVSH	SHUMA totale me TVSH
1.05.01	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 25 me blloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim.	m <sup>3</sup>	145.00	55.00 €	7,975.00 €
1.05.03	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 12 cm me blloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim.	m <sup>3</sup>	8.00	55.00 €	440.00 €
<b>TOTAL POZICIONI me TVSH</b>				1.05	8,415.00 €
1.06 PUNËT E SUVATIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me TVSH	SHUMA totale me TVSH
1.06.01	Furnizimi me material dhe suvatimi i sipërfaqeve të brendshme të mureve deri në nivelin e pllakës meskatëshe (h=320 cm) në të gjitha këndet në përdheshë dhe katin e parë si dhe suvatimi i plafoneve, me material/llaq të parapërzier (gëlqere+cimento+agregat) ose me material të ngjashëm me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me llaq sprucues ose material të ngjashëm, listelat metalike për caktimin e trashësisë së llaqit, këndoret metalike, listelat dilatuese (anputzlesite) nga plastika me rjetë armimi dhe shini vetngjithës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zdukthtarisë me folle të PVC-së si dhe rjeta e PVC-së me fije qelqi për përforcimin e llaqit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si blloqe-beton.	m <sup>2</sup>	2,800.00	6.00 €	16,800.00 €
1.06.02	Furnizimi me material dhe finalizimi i mureve dhe plafonit të këtinave teknike me llaq finalizues të hallë të parapërzier me strukturë (gëlqere + cemento + agregat + imët).	m <sup>2</sup>	345.00	4.00 €	1,380.00 €
1.06.03	Furnizimi me material dhe palinimi i mureve me dy shtresa glet-masë në të gjitha këndet në nivelin e përdheshës dhe katin I të përcaktuara me projekt.	m <sup>2</sup>	2,800.00	1.00 €	2,800.00 €
<b>TOTAL POZICIONI me TVSH</b>				1.06	20,980.00 €
1.07 PUNËT E NGJYROSJES					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me TVSH	SHUMA totale me TVSH
1.07.01	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të patinuara me dy shtresa ngjyrë me bazë poliuretani me aftësi të madhe të pastrimit. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me lyej bazë/primer për enterier për reduktimin e shkallës së apsorbtimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjithjes, etj.	m <sup>2</sup>	2,800.00	1.00 €	2,800.00 €
1.07.02	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve dhe plafoneve të suvatuara me llaq me strukturë me dy shtresa ngjyrë. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me bazë/primer për enterier për reduktimin e shkallës së apsorbtimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjithjes, etj.	m <sup>2</sup>	345.00	1.00 €	345.00 €
<b>TOTAL POZICIONI me TVSH</b>				1.07	3,145.00 €
1.08 PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMËSË					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI me TVSH	SHUMA totale me TVSH
1.08.01	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit në të gjitha këndet e brendshme me dyshemë nga pllakat qeramike duke përfshirë shtrësën ndarëse nga folia adekuate e aluminit me veti të reflektivitetit të nxehtësisë për ngrohje në dyshemë, shtrësat termoizoluese dhe zëizoluese si dhe shiritin perimetrik nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet realizimi me shtresat në vijim: • Estrih   t=7 cm • Folle/nënshtresë alumini për ngrohje gypore në dyshemë • Termoizollim   EPS@ A100   t=3 cm • Termoizollim   EPS@ T650   t= 2 cm	m <sup>2</sup>	135.77	14.00 €	1,900.78 €



1. VALMA KAMISHI ZERA  
 2. Shkurti Sample SLS  
 3. Tsa Zencari Hecani

1.08.02	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit në të gjitha kthinat e brendshme me dysHEME nga parket duke përfshirë shtresën ndarëse nga folia adekuatë e aluminit me velt të reflektimit të nxehësisë për ngrohje në dysHEME, shtresat termoizoluese dhe zëizoluese si dhe shiritin perimetrik nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet realizimi me shtresat në vijim: • Estrih   t=7 cm • Folie/nënshtrësë alumini për ngrohje gypore në dysHEME • Termoizolim   EPS® A100   t=3 cm • Termoizolim   EPS® T650   t=2 cm	m <sup>2</sup>	355.00	14.00 €	4,970.00 €
1.08.03	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit dhe termoizolimit të nënkulmit mbi tërë sipërfaqen e pllakës së fundit duke përfshirë shtresat ndarëse nga foliet adekuatë dhe shiritin perimetrik nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet realizimi me shtresat në vijim: • Estrih me trashësi 4 cm • Folie PE • Termoizolim   XPS® 30   t=12 cm (6+6 cm për mbulimin e fugave) • Rërë e imët për nivelizim sipas nevojës Në sasi është përfshirë edhe mbulimi i anës së epërme të kafazit të ashensorit dhe mbështjellja e mureve sipas detajit.	m <sup>2</sup>	365.20	12.00 €	4,382.40 €
1.08.04	Furnizimi me material dhe punimi i dyshemesë nga parketi i drurit "FERTIK PARKET" me trashësi t=16mm duke përfshirë edhe lloznet në perimetër. Lyerja me lak Akryl lak Ekologjik në menyre që parketi duhet të jetë ekologjik, antialergjik, antibakterial, rezistent ndaj ndrydhjeve, gervishjeve të zakonshme si dhe nga uji, yndyrmat dhe lëngjet tjera. Parketi shoqërohet me folie kundër kondenzimit 0.2 mm dhe termoizolim i presuar 3mm i cili redukton zhurmën 18db si dhe mbron parketin nga myku. Në çmim të përfshihen të gjitha shtresat e nevojshme për punimin e dyshemesë si autonivelanti, etj. Ngjyra e parketit të caktohet nga organi mbikqyrës.	m <sup>2</sup>	355.00	35.00 €	12,425.00 €
1.08.14	Furnizimi me material dhe punimi termoizolimit nën pllaken e themeleve (perdhese) për mbrojtjen nga lagështia. • Termoizolim   XPS 30   t=5 cm Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet e nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rjetë, etj.	m <sup>2</sup>	240.00	5.00 €	1,200.00 €
1.08.16	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit të pushimareve të shkallëve të jashtme, të rampave, dhe terasave në përdhese për nivelizimin e dyshemesë së eksteriut me dyshemenë në enterier. Në çmim të llogaritet nivelizimi me: • Estrih   t=5 cm	m <sup>2</sup>	158.00	4.00 €	632.00 €
1.08.17	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit të kthinave teknike në përdhese për ngritjen në nivelin e dyshemesë së kthinave fqinje. Në çmim të llogaritet nivelizimi me ramje drejt ujëmbledhësve me: • Estrih   t= deri 9 cm	m <sup>2</sup>	21.00	10.00 €	210.00 €
<b>TOTAL POZICIONI me TVSH</b>				<b>1.08</b>	<b>25,720.18 €</b>
<b>1.09</b>	<b>PUNËT E HIDROIZOLIMIT</b>				
<b>POS</b>	<b>PËRSHKRIMI I PUNËVE</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI/NJËSI me TVSH</b>	<b>SHUMA totale me TVSH</b>
1.9.01	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i nyjeve sanitare në përdhese & katin e parë, hidroizolimi i rampave & shkallëve të hyrjes, i terasave në përdhese. Në çmim duhet përfshirë hidroizolimin e dyshemesë në këto hapësira si dhe hidroizolimin e mureve perimetrike deri në lartësi 30 cm me hidroizolim të lëngshëm fleksibil dykomponentësh të aplikuar në dy shtresa sipas udhëzimeve të prodhuesit. Poashtu në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëlhurave të poliesterit ose rjetave me fije qelqi në kënde për të penguar plasatjen e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes. Gjatë aplikimit të materialeve të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe afatet e përcaktuara nga prodhuesi.	m <sup>2</sup>	108.00	4.00 €	432.00 €
<b>TOTAL POZICIONI me TVSH</b>				<b>1.09</b>	<b>432.00 €</b>
<b>1.10</b>	<b>PUNËT E QERAMIKËS   PORCELANIT   GRANITIT   KUARCIT  </b>				
<b>POS</b>	<b>PËRSHKRIMI I PUNËVE</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI/NJËSI me TVSH</b>	<b>SHUMA totale me TVSH</b>



1. VALINA KAMISHI ZELA  
 2. S. Kuka  
 3. S. Kuka

1.10.01	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë së këtinave teknike me pllaka të paglazuar porcelani me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përzgjidhen në koordinim me organin mbikqyrës të përcaktuar nga investitori. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rreshqitjes të klasit min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshatshme për frekuentim të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjytja e pllakave të bëhet me ngjytës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut.	m <sup>2</sup>	21.00	25.00 €	525.00 €
